



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA**

Nr. 438 Prot.

Tiranë, më 05.03.2026

VENDIM

Nr. 26, datë 05.03.2026

Për shpalljen e konkursit për pranimet e reja në Akademinë e të Rinjve të Shqipërisë

Kryesia e Akademisë së Shkencave, bazuar në nenet 5, 12 dhe 20 të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në nenet 30, 32 dhe 46 të Statutit të Akademisë së Shkencave, i ndryshuar; në vendimin nr. 63, datë 16.11.2023 të Asamblesë së Akademisë së Shkencave “Për miratimin e Kartës Themelore të Akademisë së të Rinjve të Shqipërisë”; në pikat 3 dhe 4 të Kartës Themelore të Akademisë së të Rinjve të Shqipërisë; si dhe duke marrë në konsideratë shkresën me nr. 1775/1 prot., datë 29.12.2025 të Kryetares së Akademisë së të Rinjve, dr. Belfjore Qose,

VENDOSI:

1. Të shpallet konkursi për pranimin e 8 (tetë) anëtarëve të rinj në Akademinë e të Rinjve të Shqipërisë, në përputhje me nenin 20 të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”; nenin 46 të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe në pikat 3 dhe 4 të Kartës Themelore të Akademisë së të Rinjve të Shqipërisë, duke ftuar të aplikojnë studiues të rinj nga të gjitha fushat e kërkimit shkencor, me përparësi për fushat e pa përfaqësuar ose më pak të përfaqësuar në përbërjen aktuale të Akademisë së të Rinjve.
2. Komisioni për zhvillimin e konkursit për pranimin e anëtarëve të rinj në Akademinë e të Rinjve ngrihet me vendim Kryesie.
3. Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë kandidatët përcaktohen në Shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Procedurat e konkurrit zhvillohen sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të Akademisë së Shkencave.
5. Afati për paraqitjen e interesit për konkurrim është nga data 17 mars 2026 deri më datë 17 prill 2026.

6. Verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit dhe i plotësimit të kriterëve ligjore nga komisioni pranë Akademisë së Shkencave të bëhet deri më datë 24 prill 2026.
7. Marrja e mendimit të drejtuesit të njësisë bazë të IAL-ve dhe/apo këshillave shkencorë të institucioneve kërkimore, ku kandidatët janë formuar a ushtrojnë veprimtarinë e tyre, të bëhet brenda datës 15 maj 2026.
8. Shpallja e fituesve nga komisioni bëhet jo më vonë se data 30 maj 2026.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sekretarja shkencore dhe anëtarët e komisionit të konkursit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder Gjinushi

KRYETAR



SHTOJCA 1

Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë kandidatët për pranimin në Akademinë e të Rinjve të Shqipërisë

Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 46 të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Kartës Themelore të Akademisë së të Rinjve të Shqipërisë, kandidatët për pranimin në Akademinë e të Rinjve duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Kriteret e përgjithshme

- a. Kandidati duhet të ketë një veprimtari të spikatur në fushën përkatëse të kërkimit shkencor.
- b. Kandidati duhet të jetë aktiv në veprimtarinë kërkimore-shkencore, profesionale dhe në jetën akademike e shoqërore.
- c. Kandidati duhet të ketë fituar gradën shkencore “Doktor i Shkencave” ose “Doktor” (PhD) para datës përfundimtare të paraqitjes së dokumenteve për konkurrim.
- d. Kandidati duhet të jetë, si rregull, nën moshën 36 vjeç, dhe në raste të veçanta nën moshën 38 vjeç në datën përfundimtare të dorëzimit të dokumenteve për konkurrim.

2. Kriteret shkencore dhe profesionale

Në vlerësimin e kandidatëve do të merren në konsideratë në mënyrë të veçantë:

- a. Botimet në revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare, me përparësi në revista të indeksuara.
- b. Pjesëmarrja dhe/ose drejtimi i projekteve kërkimore-shkencore kombëtare ose ndërkombëtare.
- c. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, aktivitete akademike dhe rrjete kërkimore.
- d. Angazhimi në veprimtari akademike, institucionale ose shoqërore, që lidhen me zhvillimin e shkencës dhe promovimin e saj.

3. Dokumentacioni që kërkohet për kandidim:

- a. Kërkesë drejtuar Kryesisë së Akademisë së Shkencave;
- b. Dokument që vërteton marrjen e gradës shkencore “Doktor i Shkencave” ose “Doktor” (PhD), fotokopje e noterizuar;
- c. Curriculum Vitae (CV) e plotë;
- d. Lista e botimeve shkencore, pas marrjes së gradës “Doktor i Shkencave” ose “Doktor” (PhD);
- e. Lista e veprimtarive të tjera kërkimore dhe akademike;
- f. Dy rekomandime me shkrim: nga profesorë ose studiues të fushës me tituj akademikë. Sugjerohet një rekomandim nga një anëtar i Akademisë së Shkencave, në fushën përkatëse;
- g. Çdo dokument tjetër që vërteton përmbushjen e kriterëve të konkursit.



4. Parime të përfaqësimit

Në përbërjen e Akademisë së të Rinjve synohet:

- a. Përfaqësimi i fushave kryesore të dijes, kulturës e shkencës.
- b. Ruajtja e një balancimi ndërdisiplinor midis fushave të kërkimit shkencor.
- c. Përfshirja e studiuesve të rinj me potencial të lartë për zhvillimin e mëtejshëm të kërkimit shkencor në vend.

